



Prima / Dorezuar Priljezo / Predato Received / Delivered	07-04-2022	2	viti god year
Organ / Rjeshta Organ / Jednica Org / Unit	1953	2022	113
Shtojca Prilog Appendix			
Sasia Kolicina Quantity			



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.197/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: anëtarë, nga: Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Jeton Koca -anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr. 197/2022, të datës 01.03.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “ kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.04.2022, mori këtë

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A. Nr.197/2022 të datës, 01.03.2022, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 01.03.2022, me numër protokolli 1095/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore që organi i punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, që ti bëjë kompozimin e shpenzimeve për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes (motrës).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 07.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli më datë 16.03.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A. nr. 197/2022, e datës 21.12.2022,

drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesë e datës 03.12.2021, me numër protokoll 297, për kompensim; Certifikata e bashkësisë familjare e datës 11.11.2021; Ekstrat i lindjes i datës 24.12.2013; Certifikatë e vdekjes e datës 01.09.2021; Aktvendim i datës 03.11.1980; Vendim i datës 13.08.2015, i Drejtorisë së Administratës i Komunës së Prishtinës; Akt Emërimi i datës 31.12.2013; Përgjigje në ankesë e datës 16.03.2022, me numër protokoll 1408/2022;


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e palejuar, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës certifikatë se vdekjes së datës 01.09.2021, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, del se motra e ankueses ka vdekur me datë 29.08.2021, ndërsa kërkesën për kompensim për vdekjen e anëtarit të ngushtë ankuesja e ka parashtruar me datë 03.12.2021, tek Menaxherja e Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa për shkak të heshtjes administrative me datë 01.03.2022, me numër protokoll 1095/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e që është jashtë afatit të përcaktuar ligjor për parashtrimin e ankesave.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative e ka parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor, duke vepruar në kundërshtim 127, paragrafi 4 . të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se; **4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.** Kolegji për shqyrtim dhe vendosjen e ankesave pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguar nga pala ankuese si dhe përgjigjen në ankesën të siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, ka konstatuar se ankuesja nuk ka marr përgjigje nga Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me kërkesën për kompensim lidhur me vdekjen e anëtarit të ngushtë, prandaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesja kundër heshtje ankesën në Këshill e ka parashtruar jashtë afatit ligjor.

Ndërlidhur me ankesën e ankueses të parashtruar në Këshilli, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja ka qene i obliguar që ankesën ta parashtrojë në pajtim me ligjin për zyrtarët publik, në afatin prej (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", prandaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit sepse ankesën e ka parashtruar jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesës

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA NR. A. NR. 197/2022**

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Estref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme,
- Arkivit të KPMSHCK-së

